667
17.5.21

"KALISI HYDROPOWER"sh.p.k me NIPT: L81818009A.

Adresa ; Rruga Qemal Stafa, Pallati 66,Hyrja Nr.3, Ap.24. Tiranë

Nr 24 Prot, Tiranë, më: 17/05/2021

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023,Tiranë

Lënda: Kërkesë për derogim nga Kodi i Transmetimi për mënyrën e lidhjes së Hec-Veleshica 2 me linjën elektrike 110KV Peshkopi-Lapaj.

Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k me numer NIUS L81818009A , zotëruese e Hec Veleshica 1&2 me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.71, datë 22.04.2020 është e pajisur me Licensë për Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga ERE Seria P20 me Numer License 465 .

Në zbatim të kontratës së nënshkruar me autoritet shteterore shoqëria ka vijuar punën për realizimin e Hec Veleshica 1 & 2. Hec Veleshica 1 & 2 po ndërtohen në lumin e Veleshicës dhe zonat ku kalojnë gjurmët e projektit te hec Veleshica 1 i përket bashkisë Dibër ndërsa zona ku kalon gjurma e projektit të hec Veleshica 2, pjesërisht, i përket bashkisë Kukës.Shoqëria konform përcaktimeve ligjore ka aplikaur pranë OST sh.a dhe ka lidhur Marrëveshje për Lidhje me Rrjetin e Transmetimit 110kV të Hec-ve Veleshica me nr, 531prot. datë 18.01.2019 me OST-n .Në bazë të kësaj marrëveshje lidhja e Hec-ve Veleshica 1 & 2 me fuqi të përgjithshme 13.9 MW, me rrjetin 110 kV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një nënstacioni ngritës 110/20/6.3 kv pranë Hec Veleshica 1, me fuqi transformatorike 20 MVA dhe një linjë elektrike ajrore 110 kv me dy qarqe , rreth 250m të gjatë, me përcjellës ACSR-240 mm2, duke çarë linjën 110 kv Peshkëpi-Lapaj.Lidhja e e Hec Veleshica 2 do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një nënstacioni 20/6.3 kv pranë HEC-it dhe një linjë 20 kv rreth 3.2 km të gjatë për t'u lidhur me zbarrat 20 kv të N/Stacionit 110/20 kv pranë HEC Veleshica 1.

Gjithashtu shoqëria jonë gjatë ndërtimit ka bërë kërkesë për Amendim Marrëveshje pranë OST-së për ndryshim të fuqisë së instaluar transformatorike të Nënstacionit ngritës 110/20/6.3 kV pranë hec Veleshica 1 nga 1x20 MVA në 1x25 MVA e cila është aprovuar me nënshkrimin Amendimit nr .1 " Marrëveshje për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të hec-ve Veleshica me nr, 1957.prot. datë 18.03.2021 (neni 1).

Në bazë të vendimit nr 85, datë 12.05.2020 të Bordit të ERE janë të miratuara kriteret për të vendosur derrogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike.Kjo rregullore bënë të mundur dorëzimin e kërkesës tonë për të kërkuar derrogim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KALISI HYDROPOWER
SH.P.K.
L81818009A ALBANIA

"KALISI HYDROPOWER"sh.p.k me NIPT: L81818009A.

Adresa ; Rruga Qemal Stafa, Pallati 66,Hyrja Nr.3, Ap.24. Tiranë

Bordi ERE me vendim nr 85, datë 31.05.2019 ka përcaktuar miratimin e "niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin a, b, c, d, sipas vendimit të ERE nr 129, datë 04.06.2018, " mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve". Ky vendim bën klasifikimin e gjeneruesve sipas tabelës së mëposhtme.

Tipi A	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes < 110 kv dhe Kapaciteti i moduleve $800 \leq P_{max}^{kapaciteti} < 1$ MV
Tipi B	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes < 110 kv dhe Kapaciteti i moduleve $1\ MV \leq P_{max}^{kapaciteti} < 10$ MV
Tipi C	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes < 110 kv dhe Kapaciteti i moduleve $10\ MV \leq P_{max}^{kapaciteti} < 30$ MV
Tipi D	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes < 110 kv dhe Kapaciteti i moduleve $P_{max}^{kapaciteti} > 30$ MV

Duke marrë në konsideratë tabelën e msipërme Hec Veleshica 1 & 2, me fuqi të instaluar 13.9 MW parashikon te rrjeti ne transmetimit 110 kv dhe pwr rrjedhojë klasifikohet si Modul Gjenerues i Tipit D.

Përshkrimi i derrogimit të kërkuar :

Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k zotëron koncesionare të formës BOT (bashkëlidhur kontrata e lidhur me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë) për ndërtimin e hec VELSHICA 1 DHE VELESHICA 2 me Nr. 1605 REP./ Nr. 1037/1 KOL. datë 18 korrik 2018.Shoqëria është e pajisur me leje ndërtimi Nr. 1482/9, datë 18.09.2019 dhe në zbatim të detyrimeve ligjore ka ndërtuar veprën energjitike Hec Veleshica 2 po kështu ka njoftuar dhe MIE.Aktualisht nga OST sh.a është marrë miratimi paraprak për lidhjen me rrjetin 110 kv të transmetimit.

Kodi i Transmetimit është miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, nr 186 datë 10.11.2017 , ndryshuar me vendimin nr 129 datë 04.06.2018.Në të njëjtën kohë Bordi ERE me vendimin nr 85, datë 12.05.2020 ka miratuar kriteret për të vendosur derrogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike.Bordi ERE me vendimin nr 85, dt 31.05.2019 ka bërë miratimin e "nivele kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me systemin, në tipin a, b, c, d.

Bazuar në këto akte nënligjore kërkojmë derrogim të përkohshëm për një periudhë 24 mujore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KALISI HYDROPOWER
SH.P.K.
L81818009A ALBANIA

"KALISI HYDROPOWER"sh.p.k me NIPT: L81818009A.

Adresa ; Rruga Qemal Stafa, Pallati 66,Hyrja Nr.3, Ap.24. Tiranë

Ky derrogim vjen për faktin se parashikimi i realizimit të traktit 110 KV të linjës dhe trakti 110 kv të transformatorit të nënstacionit ngritës 110/25/63 KV pranë Hec veleshica 1 mund të pajiset me të gjithë elementët e nevojshmë primarë në dy faza implementimi.Në fazën e parë parashikohet që trakti 110 KV të jetë i pajisur me thikë ndarëse për një peridhë 24 mujore dhe pas kësaj periudhe të pajiset me të gjithë elementët e nevojshëm thikë dhe çelës.

Në kushtet kur shoqëria ka përfunduar punimet për ndërtimin e hec Veleshica 2, duke njoftuar njëkohësisht edhe institucionet përgjegjëse shtetërore, ka lidhur Akt-Marrëveshje me OST-n sh.a.për lidhjen me rrjetin e transmetimit kërkojmë derrogim pranë ERE bazuar në dispozitat e nenit 12 të kodit të transmetimit por edhe rregullores së miratuar me vendimin nr.85 datë 12.05.2020

- Afati i derrogimit 24 muaj

- Objekti i derrogimit: realizimi i traktit 110 KV të linjës dhe traktit 110 të transformatorit ngritës që parashikohet të instalohet nën Nënstacionin 110/25/63 KV pranë Hec Veleshica 1 në dy faza implementimi.Në fazën e parë parashikohet që trakti 110 KV të jetë i pajisur me të jetë i pajisur me thikë ndarëse për një peridhë 24 mujore dhe pas kësaj periudhe të pajiset me të gjithë elementët e nevojshëm thikë dhe çelës.

Vlerësime të analizës kosto përfitim :

- *HEC Veleshica 1 shfrytezon ujerat e Perroit te Veleshices dhe* do te ndertohet me nje veper marrje, kanal derivacioni, nje basen presioni, tubacion presioni dhe godina e centralit.

Fuqia e Instaluar	*kW*	*5801*
Energjia totale	*kWh/vit*	*19'537'389*

-Hec Veleshica 2 do te ndertohet në lumin e Veleshicës me nje veper marrje, kanal derivacioni, nje basen presioni, tubacion presioni dhe godina e centralit.

Fuqia e Instaluar	*kW*	*8'116*
Energjia totale	*kWh/vit*	*27'717'780*

- **Fuqia e instaluar (kw)** **N= 13.917 kw**
- **Energjia mesatare vjetore kwh** **E = 47'255'169 KWh/vit**

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KALISI HYDROPOWER
SH.P.K.
L81818009A ALBANIA

"KALISI HYDROPOWER"sh.p.k me NIPT: L81818009A.

Adresa ; Rruga Qemal Stafa, Pallati 66,Hyrja Nr.3, Ap.24. Tiranë

Periudha e konçesionit të formës BOT është parashikuar 35 vjet dhe fillon me hyrjen në fuqi të kontratës.Investimi i parashikuar në kontratën koncesionare është parashikuar në vlerën **927'928'006.6 (nëntëqind e njëzet e shtatë milion e nëntëqind e njëzet e tëtë mijë e gjashtë presje gjashtë)** lekë pa T.V.SH nga të cilat rreth 790'000'000 (shtatëqin e nëntëdhjëtë milion) lekë janë investuar deri me tani.

Në bazë të kontratës koncesionare shoqëria duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktor (shtetit Shqiptar) një tarifë të barabartë me 2,2% të prodhimit vjetor të energjisë elektrike.

Duke marrë në konsideratë prodhimin mesatar E = *27'717'780* kWh/vit për Hec Veleshica 2 , tarifa koncesionare parashikohet të jetë 609,791 kWh/vit

Duke marrë në konsideratë sa parashtrohet më sipër mos vënia në punë e Hec Veleshica 2 do të shkaktonte një humbje për shoqërinë në vit prej E = *27'717'780* kWh/vit x Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 të jetë 7.448 Lekë/kWh lekë =206 442 025 Lekë

Gjithashtu nuk do do të paguhet tarifa koncesionare për llogari të Autoritetit Kontraktor në sasinë 609,791 kWh/vit x 7.448 = 4 541 723 lekë

Vënia në punë e Hec veleshica 2 do të rriste prodhimin vendas të energjisë në masën *27'717'780* kWh/vit.

Po kwshtu brenda afatit te derogimit 24 muaj do tw vihet ne pune edhe Hec Veleshica 1 me nje prodhim

E = *19'537'389* kWh/vit x Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 të jetë 7.448 Lekë/kWh leke =146'295'968 Leke

Gjithashtu nuk do do të paguhet tarifa koncesionare për llogari të Autoritetit Kontraktor në sasinë 429'822 kWh/vit x 7.448 = 3'201'318 lekë

Vënia në punë e Hec veleshica 1 do të rriste prodhimin vendas të energjisë në masën *19'537'389* kWh/vit.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë;

- Shtojcën 1 format i kërkesës për derrogim nga pronarët e moduleve gjeneruese të energjisë elektrike.
- Marreveshje per lidhjen me rrjetin nënshkruar me OST sh.a
- Amendimin e Marrëveshjes me OST-n
- Skemën e re të lidhjes të Nënstacionit Veleshica 1&2, me linjën elektrike 110KV Peshkopi - Lapaj.
- Ekstratin Historik i rregjistrit tregtar, të dhëna të subjektit " Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Për sa më sipër vlerësojmë se shoqëria jonë plotëson kriteret për të kërkuar derogimin e mësipërm në mënyrë që të realizohet lidhja e hidrocentralit me rrjetin e transmetimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KALISI HYDROPOWER
SH.P.K.
L81818009A ALBANIA

"KALISI HYDROPOWER"sh.p.k me NIPT: L81818009A.

Adresa ; Rruga Qemal Stafa, Pallati 66,Hyrja Nr.3, Ap.24. Tiranë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, shpresojmë në miratimin e kërkeses sonë!

Me respekt
"Kalisi Hydropower" sh.p.k.

HAMZ ISLAMAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KALISI HYDROPOWER
SH.P.K.
L81818009A ALBANIA

SHTOJCA 1

Formati i kërkesës për derogim nga pronarët e moduleve gjeneruese të energjisë elektrike

I– Të dhëna të përgjithshme për aplikantin

Emri	"Kalisi Hydropower" sh.p.k
Selia	Tiranë
Adresa	Rruga "Qemal Stafa", Pallati 66, Hyrja nr. 3, Ap 24, Tiranë
Adresa e emailit	info.kalisihydropower@g.mail.com
Nr.telefon	0676038701
Faks	
Aplikanti: Numri i Identifikimit në QKR Licensuar nga ERE me **Vendim Nr.....71.....datë** **Data e lidhjes së Marrëveshjes së Lidhjes...531 dt 18.01.2019**	☒ Zoteruesi i objektit gjenerues ☐ Palë e tretë(nëse moduli eshte i tipit A)
Të dhënat i përkasin: *(shënojeni kur është e përshtatshme)*	☐ Zoteruesi i objektit gjenerues ☐ Palë e tretë (nëse moduli eshte i tipit A)

II– Person kontakti i aplikantit

Emridhe mbiemri	Hamz Islamaj
Pozicioni	Administrator
Adresaeemailit	
Numratetelefonit	
Të dhënat i përkasin: *(shënojeni kur është e përshtatshme)*	☒ Zoteruesi i objektit gjenerues ☐ Palë e tretë

III–Tëdhënatbazëpërobjektin

Emri	
Tipi i modulit gjenerues(A, B, C, D, sinkron, josinkron)	Tipi D
Lloji i burimit primar të energjisë	
Vendndodhja/pika e lidhjes	Lumi Veleshicë, Bashkia Dibër. Linja 110kV Beshkop-Zapaj
Kapaciteti instaluar[kW]ose(MW)	13.9 MW
Tensionii lidhjes[kV]	110 kV
Çertifikata e pajisjes lëshuar nga nje certifikues i autorizuar *(shënojeni sipas nevojës)*	Po Jo N/A
Jetëgjatësia	35 vjet Koncesion.
Koha e pritshme e vendosjes në punë	Maj 2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KALISI HYDROPOWER SH.P.K TIRANË - ALBANIA

Referenca në dispozitat për të cilat kërkohet kufizimi dhe shkaqet e detajuara	Plotësimi i traktit 110kV me elementët primar dhe sekondar
Per sa kohe kërkohet derogimi (jave, muaj, vit)	Nga fillimi i miratimit deri 24 muaj Maj 2021 - Maj 2023

IV– Lista e dokumentave

a)Dokumentat bazë

Prova	Të paraqitura *(shënonimë poshtë kur është nevojshme)*
Përshkrimi i moduleve gjeneruese për të cilat kërkohet derogim	Po Jo
Përshkrim i detajuar për derogimin që kërkohet	Po Jo
Arsyetim i detajuar i shkaqeve së bashku me dokumentat mbështetës dhe analizën kosto-përfitim	Po Jo
Demostrim që derogimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtia ndër– kufitare	Po Jo

b)Dokumenta tëtjera

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	Analiza e kostos ne bashkëpunim e operatorin e sistemit ku eshte lidhur gjeneruesi N/A
2.	
3.	
4.	
5.	

Vendi dhe data ku është plotësuar kërkesa	Vendi: Tiranë Data:
Emri dhe Mbiemri i Personit përgjegjës	Hamz Islamaj
Firma e personit përgjegjës dhe vula	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KALISI HYDROPOWER SH.P.K. L81818009A ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MIMOZA R. SHEHU

V20210528202294457 37

DATE 17/05/2021
NR REP 3536

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 17/05/2021, para meje Noteres MIMOZA R. SHEHU, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3/3, u paraqit personalisht:

KËRKUES:
Agim Hasalami, atësia Faik, amësia Hatmane, shtetas Shqiptar, lindur në Gështejë, Kukës dhe banues në KAMËZ, me adresë Ali Demi 03940021; Nd. 83; H. 1; Paskuqan; Paskuqan; 1047; Kamëz, lindur më 05/04/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 025647173 dhe nr. personal H30405109K, .

Kontrate OST

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MIMOZA R. SHEHU

PULLE TARIFE
200 LEKE
R.SHQIPERISE

KALISI HYDROPOWER SH.P.K.
Nr._____ prot.
Tiranë, më__.03.2021

OST SH.A.
Nr. 1957 prot.
Tiranë, më 18.03.2021

AMENDIMI NR.1

I

MARRËVESHJE

PËR

LIDHJEN ME RRJETIN E TRANSMETIMIT TË HEC-EVE VELESHICA

ndërmjet

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

OST SH.A.

DHE

KALISI HYDROPOWER SH.P.K.

Sot në datë __.___.2021, duke u mbështetur në vullnetin e lirë të:

(1) **Operatori i Sistemit te Transmetimit,** (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, dt. 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me adresë: Tiranë Kashar, Yrshek, autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqësuar nga **Z.Skerdi Drenova, Administratori i OST sh.a.,**

dhe

(2) **Shoqërisë "KALISI HYDROPOWER" sh.p.k.**, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me seli të regjistruar në adresën: Tiranë, Rruga Qemal Stafa, Pallati 66, Hyrja Nr.3, Ap.24, Tiranë, Shqipëri, me Nr. NIPTI L81818009A e përfaqësuar nga Administratori i KALISI HYDROPOWER sh.p.k., **Z.Hamz ISLAMAJ**, (këtu më poshtë referuar si "**Shoqëria**")

secila referuar sipas marrëveshjes se Lidhjes Nr.531 prot, date 18.01.2019 gjithashtu si "**Pala**" ose së bashku "**Palët**" sipas rastit bien dakord që të lidhin këtë Amendament Nr.1 të Marrëveshjes së Lidhjes, sipas kushteve të mëposhtme.

Ndërsa, midis OST sh.a., dhe KALISI HYDROPOWER sh.p.k është lidhur Marrëveshja e Lidhjes Nr.531 prot., date 18.01.2019 për lidhjen në Rrjetin e Transmetimit të Hidrocentraleve Veleshicë me fuqi totale të instaluar 13,9 MW, sipas përmbatjes së saj,

Ndërsa, Shoqëria ka bërë ndryshimin e fuqisë të instaluar transformatorike në Nënstacionin ngritës 110/20/6,3 kV pranë HEC Veleshica 1 gjatë fazës së miratimit të projekt zbatimit sipas shkresës Nr.39 Prot., datë 05.02.2021.

Ndërsa, Shoqëria ka bërë pagesën përkatëse të ndryshimit të fuqisë transformatorike të Nënstacionit ngritës 110/20/6,3 kV pranë HEC Veleshica 1 nga 1x20 MVA në 1x25 MVA (është kryer pagesa e tarifës së mbikqyrjes për një shtesë fuqie prej 5'000 kVA).

Si dhe, në nenin 21 "**Ndryshimet**" të Marrëveshjes është parashikuar se:

1. Cdo ndryshim i mundshem i ndonje kushti te kesaj Marreveshje ose te nje te drejte qe rrjedh nga kjo Marreveshje, do te jete i vlefshem nese do te behet me shkrim dhe do te nenshkruhet nga palet.
2. Secila nga Palët ka të drejtë të njoftojë Palën tjetër për t'i kerkuar këto ndryshime në Marreveshje, herë pas here pasi janë të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Transmetimit, Liçensave perkatese qe ato kane, si dhe Aktin dhe/ose Kodin e Rrjetit apo ndryshimeve perkatese te tyre.

Tani e më poshtë, palët bien dakort që:

Neni 1

Kudo në Marrëveshjen e Lidhjes Nr. 531 prot, date 18.01.2019 ku është thënë "Nënstacion ngritës 110/20/6,3 kV pranë HEC Veleshica 1 me fuqi transformatorike 20 MVA" zëvëndësohet me "Nënstacion ngritës 110/20/6,3 kV pranë HEC Veleshica 1 me fuqi transformatorike 25 MVA".

Neni 2

Skemat "Skemë një fazore e N/Stacionit 110/20 kV HEC Veleshica" dhe "Skemë e mbrojtjes e N/Stacionit 110/20 kV HEC Veleshica" të Aneksit 1 te Marrëveshjes të Lidhjes zëvëndësohen me "Diagrama principale e N/Stacionit 110/20 kV HEC Veleshica" dhe "Skemë e mbrojtjes e N/Stacionit 110/20 kV HEC Veleshica" të Aneksit 1 bashkëlidhur këtij amendimi. Skema "Skema e matjes e N/Stacionit 110/20 kV HEC Veleshica" të Aneksit 2 te Marrëveshjes të Lidhjes zëvëndësohen me "Skema e matjes e N/Stacionit 110/20 kV HEC Veleshica" të Aneksit 2 bashkëlidhur këtij amendimi.

Neni 3

Të gjithë nenet e tjera të Marrëveshjes së Lidhjes nr.531 prot, date 18.01.2019 ngelen të pandryshuara.

Neni 4

Ky Amendament Nr.1 i Marrëveshjes së Lidhjes Nr.531 prot, date 18.01.2019 është hartuar në gjuhën shqipe, në 4 (katër) ekzemplarë me fuqi të njëjtë juridike, nga dy për secilën palë.

Palët lexojnë dhe, me vullnetin e tyre të lirë dhe të pacënuar, nënshkruajnë këtë amendim duke pranuar kështu kushtet e saj, në dhe për interes të qëllimeve ekonomike që përfaqësojnë.

OST sh.a.	**KALISI HYDROPOWER sh.p.k**
Nga: Z.Skerdi Drenova	**Nga: Z.Hamz ISLAMAJ**
Titulli: Administrator i OST sh.a.	**Titulli: Administrator i KALISI HYDROPOWER sh.p.k**

Aneksi Nr.1: Dokumentacioni Teknik i lidhjes me Rrjetin Kombetar të Transmetimit.



EMERTIMI FLETES

LINJA 110 KV
PESHKOPI - LLAPAJ

N.st HEC VELESHICA

KALISI HYDROPOWER Sh.p.k

NËNTOR 2020

SHKALLA 1 — | A1

LE-01DP

Scanned with CamScanner



EMERTIMI FLETES

LINJA 110 KV
PESHKOPI →LAPAJ

N.st HEC VELESHICA

KALISI HYDROPOWER Sh.p.k

BE-15
Shpk.

SHKALLA 1 | A1 | LE-01DP

Scanned with CamScanner

Aneksi Nr.2: Specifikimet teknike të Sistemit të Matjes Tregtare.

Scanned with CamScanner



Scanned with CamScanner

KALISI HYDROPOWER SH.P.K.
Nr._____ prot.
Tiranë, më__.01.2019

OST SH.A.
Nr. 531 prot.
Tiranë, më 18.01.2019

MARRËVESHJE

PËR

LIDHJEN ME RRJETIN E TRANSMETIMIT TË HEC-VE VELESHICA

PËR
KALISI HYDROPOWER SH.P.K.

ADMINISTRATOR I KALISI HYDROPOWER SH.P.K

Hamz ISLAMAJ

PËR
OST SH.A.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Klodian GRADECI

KJO MARRËVESHJE E LIDHJES ME RRJETIN E TRANSMETIMIT (në vijim referuar si "**Marreveshja**") lidhet sot në datë __.01.2019 ndërmjet:

(1) **Operatori i Sistemit te Transmetimit,** (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, dt. 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me adresë: Tiranë Kashar, Yrshek, autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqesuar nga **Z.Klodian GRADECI, Administratori i OST sh.a.,**

dhe

(2) **Shoqërisë "KALISI HYDROPOWER" sh.p.k.**, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me seli të regjistruar në adresën: Tiranë, Rruga Qemal Stafa, Pallati 66, Hyrja Nr.3, Ap.24, Tiranë, Shqipëri, me Nr. NIPTI L81818009A e përfaqësuar nga Administratori i KALISI HYDROPOWER sh.p.k., **Z.Hamz ISLAMAJ**, (këtu më poshtë referuar si "**Shoqëria**")

secila referuar sipas marrëveshjes gjithashtu si "**Pala**" ose së bashku "**Palët**" sipas rastit.

Meqënëse:

(A) Me shkresën Nr.10 Prot., dt.05/12/2018, Shoqëria KALISI HYDROPOWER sh.p.k. ka paraqitur në OST sh.a. kërkesën për lidhje me rrjetin e transmetimit të OST sh.a., të HEC-eve Veleshica 1 dhe 2 me fuqi totale të instaluar prej 13,9 MW, të vendosur në pellgun ujëmbledhës (pjesor) të lumit të Veleshicës, degë e lumit Drini i Zi.

(B) Me shkresën Nr.8263/1Prot., dt.17/12/2018 të OST sh.a, Shoqërisë KALISI HYDROPOWER sh.p.k. iu dha Oferta e Lidhjes për të lidhur në rrjetin e transmetimit të OST sh.a., të HEC-eve Veleshica 1 dhe 2 mbi lumin e Veleshicës sipas skemës principale elektrike të lidhjes së HEC-eve me sistemin e transmetimit të aprovuar (Aneksi 1);

(C) Lidhja e HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 13.9 MW, me rrjetin 110 kV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një nënstacioni ngritës 110/20/6.3 kV prane HEC Veleshica 1, me fuqi transformatorike 20 MVA dhe një linje elektrike ajrore 110 kV me dy qarqe, rreth 250 m të gjatë, me përcjellës ACSR-240 mm^2, duke çarë linjen 110 kV Peshkopi – Lapaj. Lidhja e HEC Veleshica 2 do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një N/Stacioni 20/6,3 kV pranë HEC-it dhe një linje 20 kV rreth 3,2 km të gjatë për t'u lidhur me zbarrat 20 kV të N/Stacionit 110/20 kV pranë HEC Veleshica 1. (Aneks 1);

(D) Me shkresën Nr.10 Prot., dt.10/01/2019 "Kërkesë për nënshkrimin e Marrëveshjes së Lidhjes", KALISI HYDROPOWER sh.p.k. ka informuar OST sh.a për pranimin e Ofertës së Lidhjes së HEC-eve Veleshica 1,2 nëpërmjet skemës Hyrje-Dalje në linjën 110 kV Peshkopi - Lapaj (Aneksi 1);

(E) OST-së dhe Shoqërisë i kërkohet që sipas Kodit të Rrjetit (siç përshkruhet më poshtë) të hyjë në marrëveshje për lidhjen e HEC-eve Veleshica 1dhe 2, me rrjetin e transmetimit, sipas skemës principale elektrike të aprovuar;

(F) Shoqëria është në proçes për t'u pajisur me liçensë për (Prodhimin e Energjisë Elektrike) nga ERE. Me paisjen me këtë Liçensë Shoqëria do të dorëzojë pranë OST kopje të kësaj Liçence që do ti bashkëngjitet kësaj Kontrate.

(G) Shoqëria pranon se parashikimet e përcaktuara në këtë marrëveshje janë subjekt dhe rregullohen nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe anekset e tij, Rregullorja e Proçedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit si dhe aktet e tjera dalë në zbatim të tyre, dhe i deklaron për të njohura dhe të pranuara pa asnjë kusht ose rezervë;

ATËHERE PALËT BIEN DAKORD sa më poshtë:

NENI 1 - PËRKUFIZIME

1. Të gjitha parashikimet dhe Anekset përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.
2. Me Anekse do të kuptojmë:
   a. Aneksi Nr.1: Dokumentacioni Teknik i lidhjes me Rrjetin Kombëtar të Transmetimit;
   b. Aneksi Nr.2: Specifikimet teknike të sistemit të Matjes Tregtare;
   c. Aneksi Nr.3: Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin e Telekomunikacionit;
   d. Aneksi Nr.4: Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin SCADA të Qëndrës Kombëtare Dispeçer;
   e. Aneksi Nr.5: Deklaratat e Përgjegjësisë dhe Gadishmërisë;
   f. Aneksi Nr.6: Dorëzimi i Pjesës së Linjës.

Në rast konflikti, ndërmjet përcaktimeve të bëra në Anekset e kësaj kontrate dhe dispozitave të mëposhtme, këto të fundit do të mbizotërojnë.

3. Në këtë Marreveshje, (përfshirë Anekset e saj) përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të nënkuptojnë si vijon, dhe përveç këtyre përcaktimeve çdo term tjetër i përdorur në këtë marrëveshje ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave të dhëna në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"

"Akt"	nënkupton çdo Ligj, Vendim të Këshillit të Ministrave, Udhëzim të Ministrive ose të organeve publike rregullatore ose jo, të veshura me kompetenca për të nxjerrë akte me qëllim rregullimin e një fushe të caktuar, të cilët kanë efekt mbi veprimtarinë e palëve dhe veçanërisht mbi fushën objekt i kësaj Marrëveshje.
"Marrëveshje"	nënkupton këtë Marrëveshje të lidhur midis Shoqërisë dhe OST me qëllim përcaktimin e kushteve për lidhjen në rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike të HEC-eve Veleshica 1 dhe 2.
"Përdorues"	nënkupton personat fizikë ose juridikë, të cilët furnizojnë me, ose të cilët furnizohen me energji elektrike nëpërmjet rrjetit të sistemit të transmetimit.
"Objekti"	Hidrocentralet Veleshica 1 dhe 2
"Hidrocentrali"	nënkupton, HEC-et Veleshica 1 dhe 2 me fuqi totale të instaluar 13,9 MW, konkretisht: HEC Veleshica 1 me fuqi të instaluar 8.1 MW dhe HEC Veleshica 2 me fuqi të instaluar 5.8 MW; që do të ndërtohen nga Përdoruesi

"Asetet e lidhjes"	nënkupton asetet e lidhjes (linjë elektrike ajrore 110 kV me dy qarqe, rreth 250m të gjatë dhe me përcjellës ACSR-240 mm^2), që do të ndërtohet nga përdoruesi, për të lidhur Nënstacionin 110/20/6.3 kV pranë HEC Veleshica 1 me fuqi transformatorike 20 MVA me rrjetin e transmetimit nëpërmjet çarjes së linjës 110 kV Peshkopi – Lapaj siç është paraqitur në Aneksin Nr.1.
"Nënstacion"	Nënkupton Nënstacionin 110/20/6,3 kV pranë HEC Veleshica 1 me fuqi transformatorike 20 MVA që do të ndërtohet nga përdoruesi.
"Pika e Lidhjes "	nënkupton, pikën ku objektet lidhen me rrjetin e transmetimit, që do të jetë nëpërmjet sistemit Hyrje-Dalje në linjën 110 kV Peshkopi - Lapaj.
"Pika e Matjes"	nënkupton, pikën ku matet energjia elektrike që HEC-et Veleshica 1 dhe 2 injektojnë në rrjetin e transmetimit që është e instaluar në anën e tensionit të lartë të Transformatorit të fuqisë 110/20 kV, 20 MVA.
"Komisionim"	nënkupton proçesin e testimit, kontrollit dhe kolaudimit të nënstacionit 110/20 kV dhe pjesës së linjës lidhëse, që përfshin dy daljet e reja 110 kV dhe traktin e transformatorit 110/20 kV, për të plotësuar kushtet dhe përcaktimet e parashtruara nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit.
"Liçensa"	nënkupton në çdo kohë, lëshimin e një liçense dhe veprimtarinë e saj sipas ligjit të zbatueshëm.
"Kodi i Rrjetit"	nënkupton Kodin e Rrjetit të Transmetimit të miratuar nga ERE, që është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.
"Rregullator"	nënkupton ERE (Entin Rregullator të Energjisë)
"Rrjeti i Transmetimit"	nënkupton rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike siç përcaktohet në Kodin e Transmetimit.
"Ndryshim në kontroll"	nënkupton çdo shitje, kalim, transferim, ndërprerje, qira, tjetërsim, dhurim, dorëheqje, nënshtrim, shkëmbim, ndonjë heqje tjetër dorë ose kontrolli.
"Punimet"	nënkupton punën që do të kryhet nga përdoruesi ose kontraktori i tij për të realizuar lidhjen në rrjetin e transmetimit.
"Ndërprerje të Programuara të Detyruara"	nënkupton çdo ndërprerje e detyruar nga rrethana siç përcaktohen në këtë marrëveshje e kërkuar nga OST në përputhje me këtë marrëveshje dhe që amendon ndërprerjet e planifikuara në sistem.
"Ditë Pune"	nënkupton të gjitha ditët e javës përveç të shtunës, të dielës dhe çdo ditë pushimi zyrtar në Republikën e Shqipërisë.
"Qëndra Operative e Përdoruesit"	nënkupton njësinë organizative të përdoruesit me aftësitë e nevojshme teknike e cila është ndërfaqja direkte ndërmjet objektit të përdoruesit dhe OST/Qëndrës Kombëtare Dispeçer.

Neni 2 – Objekti

(i) Objekti i Marrëveshjes është përcaktimi i termave dhe kushteve për lidhjen në Rrjetin e Transmetimit të OST sh.a., të HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, me fuqi të plotë të instaluar prej

13,9 MW, të shoqërisë KALISI HYDROPOWER sh.p.k., sipas skemës Hyrje-Dalje në linjën 110 kV Peshkopi - Lapaj. (Aneksi 1).

Neni 3 – Kohëzgjatja e Marrëveshjes

(i) Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, përveç rasteve të zgjidhjes së marrëveshjes sipas nenit 18.

(ii) Në rastin kur Përdoruesi synon ta përfundojë këtë Marrëveshje duhet të njoftojë qëllimin e saj (çfaredolloj arsye), duke njoftuar OST me anë të njoftimit të regjistruar 3 (tre) muaj përpara.

(iii) Zgjidhja e Marrëveshjes sjell shkëputjen fizike të traktit të transformatorit nga zbarat 110 kV në Nënstacionin 110/20/6.3 kV pranë HEC Veleshica 1 dhe mbylljen e harqeve në shtyllën e parë (shtylla e re Nr.66/1) të pjesës së linjës 110 kV me dy qarqe që lidh këtë nënstacion me linjën 110 kV Peshkopi - Lapaj.

Neni 4 – Deklarime dhe Garanci të Shoqërisë

Shoqëria deklaron dhe garanton OST se:

1. Përdoruesi është themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, i regjistruar pranë Regjistrit Tregtar dhe nuk është subjekt i asnjë proçedure likuidimi dhe/ose falimentimi.
2. Përdoruesi zotëron të gjitha autorizimet e nevojshme me qëllim zbatimin e punimeve që lidhen me ndërtimin, komisionimin dhe vënien në punë të objekeve dhe aseteve të lidhjes.
3. Përdoruesi disponon të gjitha mjetet, financiare, teknike dhe teknologjike me qëllim realizimin e projektit që lidhet me ndërtimin e objekteve, aseteve të lidhjes, dhe të të gjitha veprimtarive të tjera që lidhen me mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin në punë nga vetë përdoruesi. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e aseteve të lidhjes janë në ngarkim të Shoqërisë dhe përcaktohen në marrëveshjen e mirëmbajtjes që do të lidhet midis OST sh.a. dhe Shoqërisë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Operimit.
4. Përdoruesi do të zbatojë me përpikmeri të gjitha proçedurat dhe rregullat e zbatueshme në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi për ndërtimin dhe vënien në punë të objekteve dhe aseteve të lidhjes.
5. Lidhja dhe zbatimi i kësaj marrëveshje nga ana e përdoruesit nuk përbën asnjë shkelje të ligjit në fuqi në Shqipëri, dokumenteve statutore të shoqërisë dhe çdo kontrate ose marrëveshje në të cilën përdoruesi është palë.
6. Shoqëria do ti garantojë dhe sigurojë OST sh.a., përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje, të drejtën e kalimit për të hyrë dhe për të kryer punime në Nënstacionit lidhës me rrjetin e transmetimit, të përdoruesit, si dhe në sipërfaqet e tokës ku kalon traseja e linjës lidhëse.
7. Shoqëria do ti kalojë OST në pronësi asetet e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe do ti garantojë dhe sigurojë OST sh.a., gëzimin e qetë, për të përdorur dhe gëzuar pronën e kaluar, me anë të një kontrate dhurimi. Në këtë rast pika 3 e këtij neni nuk do të zbatohet për pjesën që lidhet me shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të aseteve të lidhjes.

(i) Shoqëria është themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar dhe nuk është subjekt i asnjë proçedure likuidimi dhe/ose falimentimi.

(ii) Shoqëria zotëron të gjitha Autorizimet e nevojshme dhe disponon të gjitha mjetet, financiare, teknike dhe teknologjike për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

(iii) Lidhja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje nga ana e Shoqërisë nuk përbën asnjë shkelje të ligjit në fuqi në Shqipëri, dokumenteve statutore të Shoqërisë dhe çdo kontrate ose marrëveshje në të cilën Shoqëria është palë.

Neni 5 – Deklarime dhe Garanci të OST

OST deklaron dhe garanton Shoqërinë se:

(i) OST është një person juridik publik, i cili vepron në përputhje me legjislacionin dhe të drejtën shqiptare.

(ii) OST zotëron të gjitha mjetet teknike dhe teknologjike, si dhe personelin e kualifikuar dhe të përshtatshëm me qëllim zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

(iii) Lidhja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje nga ana e OST nuk përbën shkelje të ligjeve në fuqi në Shqipëri, të dokumenteve të krijimit të saj, si dhe të çdo kontrate apo marrëveshje ku OST është palë.

Neni 6 – Detyrimet e Përdoruesit

1. Përdoruesi ka projektuar dhe do të ndërtojë me shpenzimet e veta objektet dhe asetet e lidhjes që sigurojnë lidhjen e HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, me rrjetin 110 kV të transmetimit të OST sh.a.
2. Përdoruesi do të respektojë të gjitha specifikimet teknike në lidhje me telekomunikacionin, sistemin SCADA dhe matjen, pjesë të kësaj marrëveshje dhe të detajuara në Anekset Nr.2, 3 dhe 4.
3. Përdoruesi do të përdori për të ndërtuar asetet e lidhjes, teknologjinë bashkëkohore si edhe të gjitha sistemet e sigurisë, në mbrojtje të rrjetit kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike.
4. Përdoruesi do të kryejë të gjitha punimet në lidhje me ndërtimin e aseteve të lidhjes, në përputhje të plotë me projektin e paraqitur dhe miratuar nga OSTsh.a.
5. Përdoruesi do të lejojë në çdo moment OST sh.a., punonjësit, nënkontraktoret dhe/ose personat e tretë të autorizuar prej saj, të hyjnë në zonën në pronësi të tyre ku ndodhet nënstacioni dhe linja që po ndërtohen, me qëllim inspektimin e punimeve të kryera dhe kryerjen e verifikimeve që kërkohen në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.
6. Përdoruesi garanton se me shpenzimet e tij do të ruajë të vlefshme përgjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje të gjitha autorizimet e nevojshme me qëllim mirëfunksionimin e aseteve të lidhjes.

7. Në rast se Përdoruesi kërkon shkëputjen e lidhjes elektrike nga Rrjeti i Transmetimit duhet të njoftojë OST sh.a., 3 muaj përpara dhe Shoqëria është e detyruar të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për shkëputje.

8. Përdoruesi garanton se me shpenzimet e tij do të ruajë të vlefshme përgjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje të gjitha Autorizimet e nevojshme me qëllim mirëfunksionimin e HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, Nënstacionit 110/20/6.3 kV dhe aseteve të lidhjes.

9. Përdoruesi merr përsipër të mbajë në një gjendje efiçente HEC-et Veleshica 1 dhe 2, Nënstacionin 110/20/6.3 kV dhe asetet e lidhjes që mos të shkaktojnë dëmtim te përdoruesit e tjerë të përfshirë tashmë, në Rrjetin e Transmetimit të OST sh.a.

10. Shoqeria duhet të njoftojë menjëherë OST sh.a për çdo ndryshim dhe / ose ngjarje në lidhje me karakteristikat teknike, menaxhimin, operimin dhe kontrollin e HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, Nënstacionin 110/20/6.3 kV dhe asetet e lidhjes, dhe në përgjithësi, të respektojë detyrimet për informim në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit.

Neni 7 – Dhënia e aksesit

1. Përdoruesi është i detyruar t'i japë akses të plotë OST, pa asnjë kundërshpërblim apo pretendim të çfarëdolloji, që OST të bëjë në të ardhmen zgjerimin e nënstacionit ngritës 110/20/6.3 kV për nevoja të zhvillimit të sistemit të transmetimit në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Për këtë në sheshin e nënstacionit duhet parashikuar hapësira e lirë për zgjerimin e tij sipas një planimetrie të aprovuar nga OSTsh.a.

2. Autorizimet që do të jepen nga OST sh.a., për lidhjen e një pale të tretë nëpërmjet aseteve të lidhjes të realizuara nga Shoqëria, do të jenë në respektim të nenit 28 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe Rregullores së Proçedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit.

Neni 8 – Detyrime të OST

OST duhet të:

a) marrë përsipër planifikimet dhe detyrimet përkatëse;

b) Të marrë në dorëzim Pjesën e Linjës 110 kV me dy qarqe. Pjesa e Linjës që do t'i dorëzohet dhe kalojë në pronësi OST-së, fillon tek shtylla e re Nr.66/1 deri tek shtylla e re Nr.66/2, përfshirë shtyllat, bazamentet dhe sipërfaqet e tokës së bazamenteve të shtyllave.

c) brenda një periudhe të arsyeshme nga momenti kur shoqëria ka përmbushur përcaktimet e bëra në nenin 8 dhe 10 si dhe me një njoftim me shkrim të saj, t'i sigurojë Shoqërisë akses në Rrjetin e Transmetimit, sipas kërkesës së Shoqërisë, për të mundësuar përfundimin e punimeve duke energjizuar Nënstacionin 110/20/6.3 kV pranë HEC Veleshica 1.

Neni 9 – Dorëzimi i pjesës së linjës

1. Kalimi i pronësisë së Pjesës së Linjës 110 kV me dy qarqe që fillon nga shtylla e re Nr.66/1 deri tek shtylla e re Nr.66/2 përfshirë shtyllat, bazamentet e shtyllave dhe sipërfaqet e tokës së bazamenteve të shtyllave (sipërfaqja e katërkëndëshit që formojnë këmbët e shtyllës plus një metër për anë) do të bëhet menjëherë sapo kjo linjë të jetë përfunduar dhe të jetë gati për përdorim. Ky kalim mund të bëhet edhe më parë, në qoftë se e dikton vullneti i palëve, në çdo rast, kalimi i pronësisë duhet të bëhet përpara se Pjesa e Linjës dhe Nënstacionin në fjalë të enegjizohen.
2. Kalimi i pronësisë do të bëhet me kontratë dhurimi, ku Shoqëria do të dhurojë dhe OST do të pranojë pasuritë e parashikuara në piken (1) të këtij neni.
3. Në **Aneksin 6,** pjesë e kësaj marrëveshje, jepet planimetria në të cilën janë paraqitur Pjesa e Linjës 110 kV me dy qarqe që përfshin shtyllat, bazamentet dhe linjën me gjatësi 250 m që do ti kalojë OST sh.a dhe vlera përkatëse e tyre.

Neni 10 – Lidhja me Sistemin SCADA, Telekomunikacionin dhe komunikimi me Qëndrën Kombëtare Dispeçer

1. Përdoruesit e lidhur në rrjetin e transmetimit, do të transferojnë të dhënat në kohë reale drejt Qëndrës Kombëtare Dispeçer, duke realizuar lidhjen e detyrueshme dhe telekomunikimin duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në Aneksin Nr.4.
2. Shoqëria merr përsipër integrimin e të dhënave të nevojshme të Nenstacionit te ri 110/20/6.3 kV për Kontroll-Monitorimin në sistemin SCADA të Qëndrës Kombëtare Dispeçer. Të dhënat e nevojshme per t'u integruar duhet të jenë statuset e çelsave/thikave, alarmet dhe matjet (P, Q, U, I, F) për traktet 110 kV të linjave dhe transformatorëve të këtij nënstacioni, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në Aneksin Nr.4.
3. Shoqëria merr përsipër të zbatojë të gjitha detyrimet që lindin nga Kodi i Transmetimit, Kodi i Lidhjes të cilat përfshijnë por jo vetëm, zbatimin e menjëhershëm të urdhërave të Qëndrës Kombëtare Dispeçer, përveç rasteve kur ky veprim mund të rrezikojë sigurinë e personelit ose impiantit.

Neni 11 – Testimi, Komisionimi dhe Energjizimi

1. Pas përfundimit të ndërtimit të aseteve të lidhjes dhe të HEC-eve Veleshica 1 dhe 2 e Nënstacionit 110/20/6.3 kV, përdoruesit do të njoftojnë OST, për të organizuar një grup të përbashkët pune. Roli i OST sh.a. në këtë grup pune është të asistojë gjatë testimit dhe komisionimin të pajisjeve të instaluara me qëllim lidhjen e HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Mos prezenca e stafit të OST gjatë proçeseve të testimit dhe komisionimit, i bën të pavlefshme rezultatet.
2. Për qëllimet e kryerjes së testimit dhe komisionimit të aseteve të lidhjes, Përdoruesi vë në dispozicion të OST sh.a. të gjithë dokumentacionin teknik që lidhet me funksionimin e instalimeve të tilla. Ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqipe ose angleze.
3. OST sh.a, gjithashtu mund t'i kërkojë përdoruesit që me shpenzimet e tij, të bëjë punë shtesë të paparashikuara në marreveshje por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se asete e lidhjes janë konform specifikimeve dhe kushteve të kësaj marrëveshje.

4. Përdoruesi është i detyruar të dorëzojë protokollet e plota të kontrollit dhe testimit të pajisjeve, të kryera në prani të specialistëve të OST dhe të firmosura prej tyre, si dhe të dorëzojë pranë OST, një kopje të protokolleve të pranimit (FAT & SAT), transformatorit të fuqisë, pajisjeve primare dhe sekondare.
5. Pas përfundimit të testimit dhe komisionit të parashikuar në pikën (1) të këtij neni, midis përfaqësuesve të OST dhe përfaqësuesve të shoqërisë, do të nënshkruhet protokolli i matjes tregtare të instaluar në anën 110 kV të transformatorit ngritës të nënstacionit 110/20/6.3 kV.
6. OST do të energjizojë nënstacionin lidhës me rrjetin e transmetimit 110 kV, vetem pasi të jenë plotësuar detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje, si dhe detyrimet përkatëse të përcaktuar në Marreveshjen e Operimit, për lidhjen në rrjetin e transmetimit sipas projektit të miratuar.

Neni 12 – Pajtueshmëria dhe njoftimet operacionale

1. Në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/ Kodi i Lidhjes, rregulloren dhe këtë marrëveshje, sipas grafikut të punimeve pjesë e kësaj marrëveshje, përdoruesi do të paraqesi një raport periodik dhe një çertifikatë finale performance të infrastrukturës së tij lidhëse me rrjetin e transmetimit, duke shpjeguar përmbushjen në terma sasior dhe cilësor të kërkesave teknike dhe kritereve operacionale të specifikuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, si dhe të kërkesave shtesë të parashikuara me ligj, marrëveshje bilaterale dhe/ose siç kërkohet nga OST.
2. Proçedura operative e njoftimi për lidhjen dhe energjizimin e përdoruesit do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodeve të ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity), lidhur me kërkesat për çentralet prodhuese dhe konsumatore të Energjisë Elektrike dhe detajohet si vijon:
   a) Njoftimi Operacional i Energjizimit (EON);
   b) Njoftimi Operacional i Ndërmjetëm/përkohshëm (ION),
   c) Njoftimi Operacional Final (FON), dhe
   d) Njoftimi Operacional i Kufizuar (LON).
3. Përdoruesi do të ofrojë asistencën dhe gjithë informacionin e nevojshëm për OST për të mbledhur të dhena për të verifikuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të përformancës.
4. Përdoruesi do të kontrollojë me OST çështje relevante në një fazë të hershme të projektit në mënyrë që të mundësohen korrigjimet e nevojshme para verifikimit të pajtueshmërisë së plotë për efekt të komisionimit dhe energjizimit final të lidhjes.
5. Grupi përkatës i komisionimit bashkë me njoftimet operacionale, harton edhe Lejën Teknike e cila përmban tërësinë e dokumentacionit teknik të përshkruara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit/ Kodi i Lidhjes.
6. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, shoqëria duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e Marrëveshjes së Operimit dhe ta nënshkruajë atë përpara vënies në shfrytëzim normal.

Neni 13 – Planifikimi i ndërprerjeve dhe de-energjizimi

1. Bazuar në proçedurat e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Operatori i Sistemit lejohet të bëjë menaxhimin e drejtë të situatave teknike në Sistemin Elektroenergjetik, duke marrë në konsideratë një gamë të gjërë kushtesh operacionale, në rrethana normale dhe jo normale, në kushtet e tanishme, dhe të një sistemi në të ardhmen. Në Kodin e Rrjetit nuk mund të parashikohen dhe adresohen të gjitha mundësitë operacionale, prandaj OST sh.a. në rrethana të paparashikuara në Kod, mund të veprojë vendosmërisht në zbatim të detyrimeve të veta.
2. OST sh.a. dhe përdoruesi duhet, në atë masë që është praktikisht e mundshme dhe arsyeshme, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, të koordinojnë ndërprerjet e planifikuara në rrjet.
3. OST sh.a. dhe përdoruesi do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që ndërprerjet e tilla do të jenë me kohëzgjatje minimale dhe do të shkaktojnë shqetesime minimale për të tretët dhe nuk do të dëmtojnë funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të sistemit.
4. Pavarësisht nga planifikimi vjetor i ndërprejeve, OST sh.a. do të mund të kryejë ndërprerje të programuara të detyruar dhe de-energjizim të pikës së lidhjes së përdoruesit, kur kjo kërkohet me qëllim ushtrimin e funksioneve të saj, me kushtin që të njoftojë këtë të fundit 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara ditës së kryerjes së ndërprerjeve, për ndryshimin e planit të ndërprerjeve dhe për kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruar, sipas rastit.
5. Njoftimi i OST sh.a. do të përfshijë:
   a) njoftimin dhe arsyetimin
   b) planin e ndërprerjeve të përditësuar
   c) ndërprerjen e programuar të detyruar duke specifikuar numrin e pritshëm të ndërprerjeve, kohëzgjatjen në orë dhe datat për secilën pikë lidhje ku kryhet ndërprerja.
6. Nëse përdoruesi pengon OST sh.a. në kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruar, bëhen përgjegjës për të gjitha pasojat dhe kostot që lidhen me vonesat dhe që mund ti shaktohen OST apo të tretëve me të cilët OST sh.a. është në marrëdhenie kontraktuale.
7. OST do të ushtrojë të drejtën e de-energjizimi të përdoruesit në çdo kohë dhe në afatet dhe masën që OST sh.a e vlerëson proporcionale me situatën, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, ose në ndonjë nga rrethanat e mëposhtme:
   a) Në kushtet e Forcës Madhore, kur konsiderohet se rrethanat e kërkojnë një masë të tillë;
   b) Për qëllim të realizimit të projekteve për fuqizimin e rrjetit të transmetimit;
   c) Për qëllim të realizimit të lidhjeve të reja të të tretëve në rrjetin e transmetimit;
   d) Me qëllim gjetjen dhe eliminimin e një defekti, për mirëmbajtjen, riparimin, ose testimin e një pjesë të rrjetit të cilat janë të nevojshme për të siguruar funksionimin normal dhe për të fuqizuar sigurinë operacionale të rrjetit;
   e) Nëse është e nevojshme në një situatë emergjence në aferësi të rrjetit elektrik, ose në rast nevoje për të zbutur efektet e çdo rreziku material ose humbje financiare për çdo person apo pronë të lidhur me ose pranë rrjetit;
   f) Kur kërkohet nga furnizuesi i përdoruesit për mospagesë të furnizimit me energji elektrike. Në një rrethanë të tillë OST mund të kërkojë dëshmi të mospagesës nga përdoruesi;
   g) Kur përdoruesi nuk përmbush detyrimet në bazë të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe sipas vlerësimit të OST sh.a kjo ka një efekt material të dëmshëm në rrjet;

h) Në funksion të nenit 17 Ushtrimi i të Drejtave;
i) Nëse marrëveshja mes palëve përfundon ose nëse nuk ka dakordësi midis palëve për ndryshime të rrjetit të përdoruesit (shtesë fuqie, rikonfigurim, etj).

Nëse gjatë kryerjes së punimeve ose gjatë operimit të aseteve të lidhjes, bazuar në një opinion të arsyeshëm të secilës palë, kushtet ose mënyra e veprimit të rrjetit të transmetimit ose në rast se pjesa e linjës ose nënstacioni shfaq një kërcënim të menjëhershëm për plagosje ose dëme materiale ndaj ndonjë personi ose rrjetit të transmetimit ose vetë nënstacionit, OST sh.a. mund të urdhërojë, sipas rastit, personelin operativ të nënstacionit të de-energjizojë menjëherë pjesën e linjës dhe nënstacionin ose OST sh.a. mund të de-energjizojë pjesë të rrjetit të transmetimit, në çdo rast, duke iu përmbajtur Kodit të Rrjetit të Transmetimit, nëse është e nevojshme ose e përshtashme për të shmangur shfaqjen e këtyre plagosjeve ose dëmeve.

8. Në rastet e de-energjizimit të një përdoruesi OST sh.a. do të dokumentojë shpenzimet që lidhen me de-energjizimin dhe do ti faturojë përdoruesit këto shpenzime kur:
   a) de-energjizimi është bërë me kërkesën e përdoruesit;
   b) de-energjizimi është bërë në kushtet e nenit 28 dhe përdoruesi ka qënë shkaktar për nevojën e de-energjizimit;
   c) kur de-energjizimi është bërë për shkak të shkeljes së Kodit të Rrjetit të Transmetimit apo Marrëveshjes së Lidhjes, Marreveshjes së Operimit dhe Marrëveshjes së Mirëmbajtjes.
9. Kur de-energjizimi kërkohet nga furnizuesi i përdoruesit, OST sh.a. do ti faturojë shpenzimet në lidhje de-energjizimi furnizuesit të përdoruesit.
10. OST sh.a. do të ri-energjizojë sa më parë që është e mundur përdoruesit kur ka të dhëna që rrethanat që çuan në de-energjizim nuk ekzistojnë me apo ka garanci të dokumentuar që rrethanat nuk do të përsëriten;
11. OST sh.a. mund të kërkojë nga përdoruesit e prekur nga de-energjizimi, prova të arsyeshme ose kryerjen e testimeve vetë ose me të tretë ose të lejojë OST të kryej testimet e nevojshme për të verifikuar që shkaqet e de-energjizimit janë adresuar apo nuk ekzistojnë më.
12. Kur verifikimi apo testimet kryhen nga OST sh.a. përdoruesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e kostove përkatëse.
13. Ri-energjizimi do të kryhet me koordinimin e të dyja palëve duke garantuar sigurinë e operimit të sistemit dhe shmangur efektet shqetesuese për të tretët.
14. Kostot për ri-energjizimin alokohen në të njëjtën mënyrë si kostot e de-energjizimit.

Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë si Përdorues i lidhjes

1. Pas lidhjes se HEC-eve Veleshica 1 dhe 2, në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Operimit dhe Marrëveshjes së Transmetimit (kur është e aplikueshme), Shoqëria fiton të drejtën për të injektuar energji elektrike në Rrjetin e Transmetimit në përputhje me fuqinë e instaluar të deklaruar dhe në përputhje me:
   a. Rregullat teknike për lidhje të përcaktuara nga OST sh.a;
   b. Kushtet teknike dhe ekonomike të aksesit dhe interkoneksion në rrjet të përcaktuara nga Autoriteti;

c. Rregullat e dispeçerimit të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit;
d. Kërkesat e tjera të përcaktuara në lidhje me lidhjen ne rrjetin e transmetimit e që janë të përcaktuara në Kodit e Rrjetit të Transmetimit.

2. Përdoruesi i Lidhjes nuk mund të injektojë në rrjet një fuqi më të lartë se ajo e përcaktuar në Ofertën e Lidhjes.

Neni 15 – Transferimi i marrëveshjes

1. Në rast se përdoruesi do të transferojë këtë marrëveshje të tretëve, duhet të plotësojë më parë këto kushte:
   a) Pala e tretë duhet të jetë e pajisur me liçensat e nevojshme nga Enti Rregullator i Energjisë si dhe,
   b) Të dokumentojë shlyerjen e çdo detyrim ndaj OST sh.a.,
   c) Të ketë njoftuar me shkrim OST sh.a., 3 (tre) muaj më përpara ekzekutimit të transferimit.

Neni 16 – Forca Madhore

1. Me perjashtim te rasteve shprehimisht te parashikuara ne kete Marreveshje, asnje Pale nuk do te konsiderohet ne shkelje te kesaj Marreveshje ne qofte se provon qe moszbatimi i detyrimeve te saj sipas kesaj Marreveshje eshte i shkaktuar nga nje rast Force Madhore. Forcë madhore është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë palet të përmbushin detyrimet e tyre sipas kesaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të paleve dhe nuk ndodhin për faj të tyre dhe palet nuk janë në gjendje t'i eleminojë ato, edhe pse kane ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tyre.

2. Në qoftë se çdo Palë është në pamundësi të përmbushë ndonjë ose të gjithë detyrimet e saj sipas kësaj Marreveshje për shkak të një ngjarje të Forcës Madhore, kjo Marreveshje do të jetë në fuqi për:
   a) detyrimet përkatëse të Palës mospërmbushëse do të pezullohen për një periudhë të barabartë me ngjarjen ose rrethanën e Forcës Madhore
   b) detyrimet e Palës tjetër që i detyrohet Palës mospërmbushëse sipas kësaj Marreveshje të cilat pala tjetër është e pamundur t'i përmbushë drejtpërdrejtë si rezultat i pezullimit të detyrimeve të Palës mospërmbushëse, do të pezullohen për një periudhë të barabartë me ngjarjen ose rrethanat e Forcës Madhore;

   Duke pranuar që:

   (A) pezullimi i përmbushjes është i një qëllimi jo më të madh dhe i njëkohëzgjatje jo më të madhe sesa kërkohet për Forcën Madhore;
   (B) asnjë detyrim i secilës palë i lindur përpara Forcës Madhore duke shkaktuar pezullimin e përmbushjes nuk do të falet si rezultat i Forcës Madhore;

(C) pala në Mospërmbushje njofton menjëherë Palën tjetër për ngjarjen ose rrethanën e Forcës Madhore, duke përfshirë natyrën dhe kohëzgjatjen e pritshme, dhe vazhdon t'i raporto jë rregullisht në lidhje me to gjatë periudhës së Forcës Madhore;

(D) pala mospërmbushëse përdor të gjitha mundësitë e arsyeshme për të parandaluar, shmangur ose zbutur pasojat e Forcës; dhe

(E) sa më shpejt të jetë e mundur pas shfaqjes së ngjarjes ose rrethanave të Forcës Madhore Palët do të diskutojnë për të vazhduar sa më mirë veprimet e tyre sa më gjatë të jetë e mundur në përputhje me këtë Marreveshje dhe Kodin e Rrjetit.

Neni 17 – Rastet e Mospërmbushjes

1. Nëse konstatohet se përdoruesi është në shkelje/mos përmbushje te ndonje prej dispozitave te marreveshjes, Kodit te Rrjetit te Transmetimit apo kuadrit ligjor atehere OST ne perputhje me kompetencat e saj, sa me shpejt qe eshte e mundur do te njoftoje perdoruesin duke udhezuar ate per eliminimin e tyre dhe duke percaktuar afatet perkatese per kete qellim.
2. Ne vijim te njoftimit nga OST dhe zbatimit te udhezimeve per eliminimin e shkeljes/mos permbushjes nga ana e perdoruesit ky i fundit do te njoftoje OST brenda afatit te caktuar ne udhezimet e dhena prej saj, ose brenda 5 diteve pune nese OST nuk ka specifikuar afat tjeter, per hapat e ndermarra per eliminimin e shkeljes ose eliminimin perfundimtar te saj ose paaftesine per te eliminuar shkeljen.
3. Nese perdoruesi nuk vepron ne perputhje me udhezimin e OST, standardet e sigurise, Kodin e Rrjetit te Transmetimit dhe Marreveshjen e Lidhjes dhe Operimit, OST do te jape nje njoftim te dyte paralajmerues me shkrim dhe do te procedoje me de-energjizimi pas kalimit te se paku 7 (shtate) dite nga ky njoftim, me kusht qe ne kohen e skadimit te njoftimit, perdoruesi ende nuk ka vepruar ne perputhje me udhezimet e OST.
4. Përjashtimisht nga sa parashikohet me larte, kur perdoruesi nuk permbush detyrimet e tij sipas kushteve te kesaj marreveshje dhe OST e vlereson te nevojshme ushtrimin emergjent te funksioneve te saj, ka te drejte te de-energjizoje menjehere nenstacionin dhe te njoftoje me shkrim perdoruesin per shkaqet e ketij de-energjizimi. Perdoruesi ne kete rast do te pergjigjet per demet e shkaktuara OST-se dhe do te marre masat per korrigjimin e situates dhe/ose permbushjen e detyrimeve te saj, sa me shpejte te jete e mundur. De-energjizimi do te vazhdoje deri sa perdoruesi te korrigjoje situaten dhe/ose te permbushe detyrimet e tij.

Neni 18 – Zgjidhja e marrëveshjes

1. OST sh.a ka të drejtë, në çdo kohë, të zgjidhë marrëveshjen, nëse verifikohet çdonjëra nga sjelljet e mëposhtme:
   a. Shoqëria nuk respekton përcaktimet e bëra në këtë marrëveshje, në ofertën e lidhjes dhe projekt-zbatimin përfundimtar të pranuar nga OST.
   b. Pezullimi i një ose më shumë lejeve për qasje dhe lidhjen me Rrjetin e Transmetimit;
   c. Dështimi për të ndjekur kushtet teknike dhe ekonomike të lidhjes me Rrjetin e Transmetimit dhe interkoneksionit;
   d. Dështimi për të përmbushur detyrimet për informim të OST

e. Çdo sjellje tjetër që mund të rrezikojnë sigurinë dhe vazhdimësinë e Shërbimit të të Operimit të rrjetit elektrik ose është në mënyrë të qartë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Rrjeti.

2. Në raste të tilla, shkëputja fizike, do të bëhet pas përfundimit të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit të sipër përmendur.

3. Shoqëria në këtë rast do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara OST-së.

Neni 19 – Konfidencialiteti

1. Secila nga Palet merr persiper qe te ruaje sekret permbajtjen e kesaj Marreveshje dhe kushtet e saj, si dhe çdo informacion dhe/ose dokument qe Palet kane shkembyer ose kane marre dijeni gjate negocimeve te kesaj Marreveshje, me perjashtim te rasteve kur berja publike e sa me siper eshte kerkese e ligjeve shqiptare.

2. Detyrimi per te ruajtur sekret informacionet e marra si me siper per secilen nga Palet ne kete Marreveshje vazhdon edhe pas zgjidhjes se saj.

Neni 20 – Njoftimet

1. Perveç sa eshte parashikuar ndryshe ne nenet e tjera te kesaj Marreveshje, çdo komunikim sipas saj do te behet me shkrim dhe do te njoftohet me leter rekomande (njoftim marrje), por paraprakisht do te komunikohet nepermjet faksit, ne adresat e percaktuara me poshte:

Për OST, në:

Adresa:	OST Sh.a.
Adresa Postare:	Autostrada Tirane-Durres, Km 9, Yrshek, Kashar, Tirane, Shqiperi
Numri i Telefonit:	+355 4 2225581
Adresa e Postes Elektronike:	info@ost.al
Ne Vemendje te:	Administratorit te OST sh.a.

Për Përdoruesin, në :

Adresa:	KALISI HYDROPOWER sh.p.k.
Adresa Postare:	Tiranë, Rruga Qemal Stafa, Pallati 66, Hyrja Nr.3, Ap.24, Tiranë, Shqipëri
Numri i Telefonit:	0676040062
Adresa e Postes Elektronike:	
Në Vëmendje të:	Administratorit te KALISI HYDROPOWER sh.p.k.

ose ne adresen dhe/ose numrin e faksit qe u komunikohet paleve sipas menyres se percaktuar me siper.

2. Çdo komunikim i drejtuar ne adresat e mesiperme dhe i kryer sipas menyres se percaktuar me siper eshte i vlefshem dhe i detyrueshem per Palet. Komunikimet konsiderohen te kryera ne menyre te vlefshme ne momentin e marrjes se letres rekomande nga marresi sipas menyres se percaktuar me siper.

Neni 21 – Ndryshimet

1. Cdo ndryshim i mundshem i ndonje kushti te kesaj Marreveshje ose te nje te drejte qe rrjedh nga kjo Marreveshje, do te jete i vlefshem nese do te behet me shkrim dhe do te nenshkruhet nga palet.
2. Secila nga Palët ka të drejtë të njoftojë Palën tjetër për t'i kerkuar këto ndryshime në Marreveshje, herë pas here pasi janë të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Transmetimit, Liçensave perkatese qe ato kane, si dhe Aktin dhe/ose Kodin e Rrjetit apo ndryshimeve perkatese te tyre.

Neni 22 – Ndashmëria

1. Çdo nen, dispozite, seksion, paragraf apo nen-ndarje e kesaj Marreveshje qe eshte ose do te shpallet i pavlefshem/ e pavlefshme ose te paefektshme, do te hiqet nga Marreveshje, nuk do te zbatohet dhe nuk do te ndikoje, ne asnje menyre, ne vlefshmerine e dispozitave te tjera te kesaj Marreveshje, per aq sa lejohet nga dispozitat ligjore.

Neni 22 – Ligji i zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreveshjeve

1. Kjo Marreveshje eshte hartuar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise dhe do te zbatohet dhe interpretohet ne perputhje me te.
2. Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin si pasoje e interpretimit dhe zbatimit te kesaj Marreveshje, kur kane te bejne me interpretimin e dispozitave te Kodit te Transmetimit, do te zgjidhen ne perputhje me proçedurat e parashikuara ne te. Ne çdo rast tjeter Palet do te mundohen t'i zgjidhin mosmarreveshjet me mirekuptim midis tyre dhe kur kjo eshte e pamundur, mosmarreveshjet, kur nuk i nenshktrohen dispozitave te Kodit te Rrjetit Transmetimit, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 19-Gjuha

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kete marreveshje, te gjitha njoftimet, ose dokumente te tjera qe njera nga palet i jep pales tjeter sipas kesaj marreveshje, do te jene ne gjuhen Shqipe.
2. Kjo marreveshje eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen shqipe, ku tre kopje i mban OST sh.a dhe nje kopje perdoruesi.

OST sh.a.	**KALISI HYDROPOWER sh.p.k**
Nga: Z.Klodian GRADECI	**Nga: Z.Hamz ISLAMAJ**
Titulli: Administrator i OST sh.a.	**Titulli: Administrator i KALISI HYDROPOWER sh.p.k**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KALISI HYDROPOWER
SH.P.K.
L81818009A ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81818009A	
2. Data e Regjistrimit	18/06/2018	
3. Emri i Subjektit	KALISI HYDROPOWER	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	14/06/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 14/06/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Qemal Stafa, Pallati 66, Hyrja Nr.3, Ap.24.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndërtim dhe Operim i Hidrocentralit Veleshice si dhe transferim i tyre ne perfundim te kontrates Koncensionare tek Autoriteti Kontraktor.	
10. Administratori/ët	Hamz Islamaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 14/06/2018	Deri: 14/06/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	BE - IS SH.P.K	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 99.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	99,00	
12.4 Komente (nëse ka)		

13. Ortakët 13.1 Vlera e kapitalit 13.2 Numri i pjesëve 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	EL- PROM	
	Para: 1.000,00	Natyre:
	1,00	
	1,00	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: KALISI HYDROPOWER Telefon: 0676040062	
16. Statusi:	Aktiv	

Lista e Dokumenteve:
Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)
Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)
Dokumenti i autorizimit
Akti i themelimit

Regjistrimi Fillestar: CN-822860-06-18

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
01/10/2019	Numri i ceshtjes: CN-296118-07-19 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Pasqyrave financiare te vitit 2018. Lista e Dokumenteve: kalisi vendim.PDF KALISI HYDROPOWER Pasqyra e pozicionit financiar (4).xlsx BILANCI 2018-kalisi.PDF kalisi p perfomances.xlsx
27/07/2020	Numri i ceshtjes: CN-557677-07-20 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare të vitit 2019.

	Lista e Dokumenteve: BILANCI VITI 2019.PDF KALISI HYDROPOWER Pasqyra e pozicionit financiar (4).xlsx7_25_2020.xlsx kalisi p perfomances.xlsx7_25_2020.xlsx VENDIMI I ORTAKEVE.pdf
16/10/2020	Numri i ceshtjes: CN-603351-10-20 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 12.10.2020 ku eshte vendosur:Depozitimi i Marreveshjes Siguruese Nr.3394Rep., Nr.1742Kol date 26.08.2020 lidhur midis bankes "Raiffeisen Bank dhe shoqerise KALISI HYDROPOWER , per barresimin e kuotave te shoqerise.Depozitimi i Marreveshjes Siguruese Nr.3394Rep., Nr.1742Kol date 26.08.2020. Lista e Dokumenteve: Vendim i asamblese se pergjithshme Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar) Dokumenti i autorizimit Akti i venies se pengut mbi pjesemarrjen e kapitalit

Datë: 17/05/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2021/05/17 14:26:40 +02:00
L81818009A2021051714262176
3006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*